

BASHKIA GRAMSH
NR REGJ 349.
Mbërriti me Date

24-01-2024



BASHKIA GRAMSH


RELACION TEKNIK

“ RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9-VJEÇARE RILINDJA ”

JANAR -2024-

Të përgjithshme

Objekti i cili do të nënshtrohet rikonstruksionit është e tipit godine arsimore e cila ndodhet në brendësi të qytetit të Gramshit. Objekti ndodhet në Perëndim të bulevardit kryesor të qytetit "10 Korriku" dhe në veri kuzohet me rrugën "Qazim Dermishi". Objekti i cili do të pësojë rikonstruksion, shkolla 9-vjeçare Rilindja ndodhet në një lartësi prej 204 metra nga niveli i detit. Ky objekt në vetvete është institucion arsimor dhe ka një funksionalitet të larmishëm në organizimin e evenimenteve arsimore - kulturore për qytetin e Gramshit. Qyteti i Gramshit pozicionohet në jug-lindje të Gramshit, i cili karakterizohet nga një reliev kodrinor –malor dhe klimë relativisht të ftohtë në dimër dhe të nxehtë në verë. Për nga ana kulturore dhe historike qyteti i Gramshit në raport me numrin e popullatës spikat dhe vlen të përmendet se është një zonë që ka çfarë të ofrojë kur bëhet fjale për arsimin dhe kulturën.



Përsa i përket objektit të shkollës 9-vjeçare Rilindja, pjesë e kësaj relacioni teknik, duhet theksuar se ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave ndërkohë. Ky objekt është ndërtuar shumë kohe më parë aty rreth viteve 1966, dhe si rezultat i kohës kushteve atmosferike paraqet amortizime të dukshme në pjesën dermuese, gjë që e bën të vështirë funksionalitetin e vetë, atë të mesdhenies dhe përcjelljes së dijeve tek brezat... Vlen të përmendet, se ky objekt me emërtimin shkolla 9-vjeçare Rilindja, i është nënshtroar në vitin 2009 edhe një rikonstruksion tjetër të pjesshëm.

Gjendja aktuale e objektit shkolla 9-vjeçare “ Rilindja”

Aktualisht objekti i shkolles 9-vjeçare Rilindja paraqitet i amortizuar dhe ky amortizim ndikon ne veshtiresite e funksionalitetit te godines. Nga inspektimi në vend që është bërë nga specialistët e Bashkisë së Gramshit është konstatuar se çatia e objektit eshte e amortizuar dhe lageshtia ka deportuar ne brëndesi te klasave duke krijuar kushte të papershtatshme. Gjithashtu nga inspektimi ne vend eshte konstatuar amortizim edhe tek suvaja e brendshme dhe e jashtme. Nje gjendje jo e kenaqshme paraqitet edhe per dyshemen e objektit te shkolles 9-vjeçare Rilindja, e cila per konkluzionin e specialisteve te Bashkise duhet te pesoj rikonstruksion duke e veshur me pllaka te reja. Eshte konstatuar qe edhe sistemi elektrik shfaq amortizim ku do ti nenshtrohet rikonstruksionit ku do te pasurohet edhe me shtesa,ketu duhet shtuar qe edhe linja e internetit paraqitet me mangesi te theksuar.Gjate inspektimit ne vende eshte verejtur se plani/sistemi hidraulik i objektit shfaqet i amortizuar.



Kjo shkolle 9-vjeçare, nuk eshte e pajisur me nje sistem/projekt e mbrojtjes nga zjarri,shkalle emergjence dhe per me teper nuk ka nje sistem kaldaje.



JANAR -2024-

Eshte konstatuar qe edhe dyert e brendshme te klasave, salla e mesuesve paraqiten ne nje gjendje jo te mire,kjo e shoqeruar edhe me pjesen arreduese,pra derrasat e zeza, bangat etj. Gjithashtu gjendja e kesaj shkolle 9-vjeçare paraqitet teper e amortizuar,sidomos kur behet fjale per terrenet sportive,gjelberimin, dhe murin rrethues.



Njekohesisht duke menduar rendesine e oborrit te shkolles si nje vend ku shvillohet jeta ne kolektiv e nxenesve, nderveprimi midis tyre dhe aktivitete shkollore te ndryshme e shohim te arsyeshme te nderhyjme ne sistemimin e tij per rritjen e cilesise se ambjentit ne shkolle.

Mendojme qe duhet nderhyre ne oborrin kryesor duke rritur cilesine e tij duke menduar qe ai eshte prezantimi i pare. Kjo siperfaqje ka nevojte per nivelim pastaj te shtrohet me pllaka betoni te presuara mbi jastek rere sipas detajit perkates.


Duke u nisur nga pozicioni i shkolles , rendesia qe ka imazhi i saj , nevoja per rrethim te objektit kemi menduar se eshte e nevojshme heqja e murit rrethues egzistues i cili eshte demtuar dhe ne disa vende nuk e luan rolin e vet. Riberja e nje muri rrethues me beton mur tulle ne dukje dhe kangjella eshte me se e nevojshme.

Ne perfundim, kjo shkolle ka nevojte edhe lysterjen e brendshme dhe te jashtme , e cila aktualisht paraqitet e perhumbur.

Vizioni i Rikonstruksionit te objektit shkolla 9-vjeçare “ Rilindja”

Siç e përmendem edhe më lart rikonstruksioni i objektit shkolla 9-vjeçare “ Rilindja”do ti sherbeje jo vetem perditshmerise se aktivitetve te mesimdhenies dhe mesimnxenies,por edhe te ate te prezantimit te Gramshit si nje qytet qe mendon apo ka nje vizion te kohes per institucionet arsimore.

Rikonstruksioni i ketij objektit do ta beje jeten arsimore dhe kulturore te qytetit me te larmishme dhe me dinamike, gjithashtu edhe funksionaliteti do te jete me komod dhe me i aksesueshem per nxenesit,brezat dhe stafin qe punon aty.



Ky objekt deri me tani ka vuajtur edhe per nje sistem ngrohje,e cila futet si ze qe ka krijuar veshtiresi ne funksionalitetin e ketij institucioni. Bashkia Gramsh nepermjet ketij projekti per rikonstruksion,ka menduar edhe per kete detaj,ku shkolla 9-vjeçare “Rilindja” do ti shtohet edhe sistemi i ngrohjes.

I gjithë ky rikonstruksion total deri ne detaje do ta rehabilitoje per nje periudhe afat gjate objektin shkolla 9-vjeçare “Rilindja”,ku do te coje ne permisimin e kushteve te ketij institucioni arsimor dhe ne kryerjen sa me komode te funksionit te tij.

Relatoi :

Ing. Orgent Çoniku



Miratohet :

Kryetari

Besion AJAZI

